




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.Sh. "Yeni Donem KTM"
Numri i biznesit - 80646356
Pronar- Ali ÇANKAJA
1. RADIO BALLKAN
2. TV BALLKAN
Prizren

Ref:1904/530/LIC/ni

VENDIM

për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës të Radio Ballkan dhe TV Ballkan, me seli në Prizren

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Ballkan është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për ofrimin e shërbimeve mediale audio (radio) përmes transmetimit tokësorë analogë në regjionin e Prizrenit, me seli në Prizren. KPM, me datën 30 tetor 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës afatgjate për Radio Ballkan.
3. TV Ballkan është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizual i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për ofrimin e shërbimeve mediale audiovizuale (TV) përmes transmetimit tokësorë analogë në regjionin e Prizrenit, me seli në Prizren. KPM, me datën 30 tetor 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës afatgjate për TV Ballkan.
4. Më datën 27 mars 2019, pronari i Radio dhe TV Ballkan, përmes një shkrese të dorëzuar në KPM, ka njoftuar heqë dorë nga licenca e KPM-së.

Arsyetimi

5. Me anë të njoftimit me shkrim të datës 27 mars 2019, pronari i Radio dhe TV Ballkan ka njoftuar se, për arsye shëndetësore dhe financiare, nuk mundet që më tutje të vazhdoj veprimtarin e transmetimit të programeve radio dhe televizive.
6. Duke marrë parasysh njoftimin për heqje dorë nga licenca në mënyrë vullnetare, Komisioni konstaton se ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës të Radio Ballkan dhe TV Ballkan.

VENDIM

7. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 26 prill 2019, merr vendim për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Ofruesve të Shërbimeve Mediale me transmetim tokësor analog Radio Ballkan dhe TV Ballkan, ndërsa, shlyerja e obligimeve financiare ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së, të bëhet në pajtueshmëri me procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi.
8. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



06. 05. 2019
datë